



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RAPORT

MONITORIMI I MEDIAVE

GJATË FUSHATËS SË

ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME 2017

31 maj – 11 qershor 2017
Prishtinë

Përmbajtja

I.	AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT	3
II.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
III.	BAZA LIGJORE	5
IV.	METODOLOGJIA DHE REALIZIMI.....	5
V.	GJETJET NGA MONITORIMI.....	7
	Shkeljet e gjetura dhe veprimet e KPM-së	8
	<i>Spotet politike të pidentifikuara</i>	8
	<i>Prezenca e fëmijëve në spote politike</i>	8
	<i>Publikimi i sondazheve/hulumtimeve të opinionit.....</i>	9
	<i>Periudha e heshtjes zgjedhore</i>	9
	<i>Shkelje të Kodit të Etikës.....</i>	10
	<i>Mos ofrimi i ditarëve me dhe pa pagesë të të licencuarve që kanë mbuluar fushatën zgjedhore</i>	11
VI.	ANKESAT E PARASHTRUARA	11
VII.	HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-TË.....	12
	<i>OSHMA me transmetim tokësor me mbulim nacional</i>	12
	<i>OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Prizrenit</i>	14
	<i>OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Mitrovicës</i>	15
	<i>OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Gjilanit.....</i>	16
	<i>OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Pejës.....</i>	17
	<i>OSHMA me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes.....</i>	18
VIII.	SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË GJATË MONITORIMIT TË PAJTUESHMËRISË SË TË LICENCUARVE TË KPM-SË.....	20
IX.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	21

I. AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT

KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
DMA	Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së
SCP	Subjekt i Certifikuar Politik
OSHMA	Ofrues i Shërbimit Medial Audio-Vizuel
TV	Televizion
RTV	Radio dhe Televizion
DITARI	Regjistër i evidencave të hapësirave që OSHMA ka ofruar për SCP-të
JGP	Jedinstvena Goranska Partija
PAN	PDK-Partia Demokratike e Kosovës; AAK Nisma për Kosovën; NISMA Partia e Drejtësisë; PDLëvizja për Bashkim-LB Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës-PSHDK - Partia Konservatore e Kosovës-PK Alternativa Demokratike e Kosovës-ADK Republikanët e Kosovës-REK Partia e Ballit-PB) BKK- Partia Socialdemokrate-PSD Balli Kombëtar i Kosovës
PAI	Partia e Ashkalinjëve për Integrim
G I	Eromendje Alternativa
GIG	Gradanska Inicijativa Gore
LAA	Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK; Aleanca Kosova e Re – AKR; Alternativa
PG	Pokret za Gora
PDS	Progresivna Demokratska Stranka
PDAK	Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës
IRDK	Iniciativa e re Demokratike e Kosovës
SLS	Samostalna Liberalna Stranka
GiSL	Gradanska Inicijativa Srpska Lista
NSK	Napredna Snaga Kosova
PLE	Partia Liberale Egjiptiane
KNRP	Kosovaki Nevi Romani Partia
KDTP	Kosova Demokratik Türk Partisi
PDU	Partia Demokratike e Unitetit
NDS	Nova Demokratska Stranka
KTAP	Kosova Türk Adalet Partisi
VV	Lëvizja Vetëvendosje
PREBK	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioni i Pavarur i Mediave ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) të cilat kanë mbuluar fushatën e zgjedhjeve të përgjithshme 2017. Monitorimi ka pasur për qëllim vlerësimin e performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII “Mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve” të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në këtë raport prezantohen të gjeturat nga monitorimi të realizuar nga zyrtarët e Departamentit për Monitorim dhe Analiza (DMA) në periudhën nga 31 maj deri më 11 qershor 2017. Monitorimi është bërë për programet e transmetuara nga ora 16:00 deri më 24:00.

Për këtë qëllim, janë monitoruar 23 ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuale (OSHMA) me transmetim tokësor me mbulim nacional, regjional e lokal si dhe OSHMA-të me program gjeneralistik të cilët operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes.

Për shkak të problemeve teknike me pranim dhe arkivim të sinjalit për këtë periudhë në raport nuk janë përfshirë *TV ZOOM dhe TV KISS*, kurse *TV Tema* prezantohet vetëm pjesërisht. .

Gjatë monitorimit janë vlerësuar: paanshmëria në raportim, hapësira e ofruar për SCP-të, gjuha e përdorur si dhe pajtueshmëria me obligimet që dalin nga Kreu VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Edhe pse fushata zgjedhore me spote politike e debate zgjedhore në OSHMA-të ka filluar shumë kohë para shpalljes zyrtare të fushatës zgjedhore nga ana e KQZ-së, raporti përmban të dhëna vetëm për periudhën 31 maj - 11 qershor 2017.

Lidhur me transmetimin e aktiviteteve zgjedhore para shpalljes zyrtare të fushatës zgjedhore, Komisioni i Pavarur i Mediave ka dërguar tek OSHMA-të një shkresë përmes së cilës ka kërkuar që të përmbahen nga transmetimi i debateve, spoteve dhe aktiviteteve tjera që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Është vlerësim i përgjithshëm, rezultuar nga të gjeturat e monitorimit, se prezantimi i fushatës 10 ditore për zgjedhjet e përgjithshme nga OSHMA-të është bërë kryesisht në mënyrë objektive dhe të paanshme, në pajtim me dispozitat për media në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Shkeljet e evidentuara nga monitorimi kishin të bëjnë me mosidentifikimin e spoteve politike, prezencën e fëmijëve në spote si dhe në disa raste thyerje e heshtjes zgjedhore.

Gjatë periudhës monitoruese, OSHMA-të kanë ofruar edhe materiale edukuese të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së) lidhur me përgatitjet dhe vet procesin e votimit, të cilat kanë qenë ndihmesë për qytetarët në ditën e votimit, më 11 qershor 2017.

Në garën për Zgjedhjet e Përgjithshme 2017 kanë konkurruar 26 Subjekte të Certifikuara Politike (SCP).

III. BAZA LIGJORE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat Gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka përcjell tek të gjithë licencuarit Udhëzuesin, i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet, i cili përbëhet prej:

1. KAPITULLIT I –identifikimi i reklamimit politik;
2. KAPITULLIT II – raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet; dhe
3. KAPITULLIT III – periudha e heshtjes zgjedhore.

Sipas nenit 53 të këtij Ligji, KPM siguron që të licencuarit mirëmbajnë ditarë për të regjistruar kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera të medieeve, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti.

Për këtë qëllim, para fillimit të fushatës, KPM ka dërguar tek të licencuarit format e ditarëve me dhe pa pagesë, si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre.

IV. METODOLOGJIA DHE REALIZIMI

Metodologjia e përdorur gjatë monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele në periudhën e Zgjedhjeve të Përgjithshme 2017 është bazuar në analiza sasiore dhe cilësore , me theks të veçantë të edicioneve qendrore të lajmeve, kronikave zgjedhore, spoteve politike si dhe intervistave e debateve në transmetimet televizive nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Me qëllim të arritjes së treguesve sasior dhe cilësor të mbulimit të fushatës zgjedhore përmes sistemit të monitorimit janë bërë regjistrimet e programeve, kategorizimi i tyre, matjet e kohës/hapësirës së dedikuar secilit Subjekt të Certifikuar Politik (SCP) prej orës 16:00-24:00, dizajnimi i tabelave për futjen e të dhënave, vlerësimi i prezantimit të fushatave si: pozitive, negative apo neutrale, përpunimi dhe analiza e të dhënave të fituara si dhe hartimi i raportit final lidhur me mbulimin medial të fushatës zgjedhore.

KPM posedon sistemin e monitorimit përmes të cilit bëhet pranimi, incizimi dhe arkivimi i programeve të transmetuara të OSHMA-ve varësisht nga nevojat e KPM-së. Matja e hapësirës së dedikuar SCP-ve është bërë duke llogaritur kohën në sekonda (në lajme, intervista, debate dhe kronika zgjedhore).

Bazuar në këto llogaritje janë dhënë tabelat për kohën e ofruar për SCP në sekonda dhe përqindje.

Analizat janë bërë për të vlerësuar nëse:

- mbulimi i aktiviteteve të të gjitha subjekteve të certifikuara politike nga OSHMA-të ishte objektiv dhe i paanshëm në kuptimin e raportimit të drejtë dhe korrekt gjatë transmetimit të aktiviteteve të fushatave të SCP-ve, qasjes së njëjtë ndaj SCP-ve në debate/intervista, pyetje të njëjta, mundësi për replikë në emisione debatuese, renditjes së aktiviteteve zgjedhore në lajme e kronika zgjedhore (renditja me rotacion duke mos favorizuar në prezantimin e aktiviteteve të SPC-ve me renditje të njëjtë çdo ditë të fushatës;
- Janë ofruar mundësi të njëjta për promovimin e platformave politike të SCP-ve në garë (hapësira e vënë në dispozicion për SCP në emisione informative, debate, intervista gjatë shpalosjes së programeve nga përfaqësuesit e SCP-ve); dhe
- Nëse është vepruar në pajtueshmëri me heshtjen zgjedhore dhe dispozitat tjera të Ligjit për Zgjedhje, gjatë transmetimit të informatave rreth procesit zgjedhor dhe mbarëvajtjes së votimit, deklaratat e transmetuara, intervistat e konferencat për media të SCP-ve.

Analiza ka përfshirë edhe vlerësimin e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-ve me të cilën është vlerësuar nëse OSHMA-të kanë prezantuar fushatat e SCP-ve në pajtim me Kodin e Etikës dhe standardet profesionale të gazetarisë (nëse ka pasur gjuhë të papërshtatshme, nxitje të urrejtjes, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës).

Të dhënat në këtë raport janë të periudhës së monitorimit nga data 31 maj deri më 11 qershor 2017 gjatë së cilës KPM ka monitoruar performancën e 23 ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA) gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore.

Në monitorim janë përfshirë OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim lokal/regjional (*TV PRIZRENI, TV BESA, TV OPINION, TV MITROVICA, TV MIR, TV MOST, TV LIRIA, TV HERC, TV PULS, TV VALI, TV ILIRIA, TV DUKAGJINI* dhe *TV SYRI VISION*), OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim nacional (*RTK1, KTV* dhe *TV21*) dhe OSHMA-të me program gjeneralistik të cilët operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (*RTK2, TV KIM, RROKUM TV, KLAN KOSOVA* dhe *TRIBUNA CHANNEL*).

TV BALLKAN (TV stacion me transmetim tokësor me mbulim regjional) nuk ka mbuluar fushatën zgjedhore kurse të dhënat për *TV TEMA*, për shkaqe teknike të arkivimit të sinjalit mbulojnë vetëm periudhën prej datës 5 deri më 11 qershor 2017.

Për shkak të problemeve teknike me arkivim të sinjalit në raport nuk janë përfshirë *TV ZOOM* dhe *TV KISS*.

V. GJETJET NGA MONITORIMI

Mbulimi i garës elektorale nga ana e OSHMA-ve gjatë Zgjedhjeve të Përgjithshme 2017 ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht Kreun VIII –“ Mediat Gjatë Fushatës Zgjedhore”.

Gjatë kësaj periudhe, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale (OSHMA) kanë prezantuar fushatat e subjekteve të certifikuara politike pjesëmarrëse në këtë garë, duke ofruar kështu hapësirë dhe mundësi për prezantimin e platformave të tyre politike. Nga OSHMA-të janë ofruar hapësira për prezantim me pagesë dhe pa pagesë për SCP-të ndërsa pikat e transmetuara reklamuese me përjashtim të disa rasteve janë identifikuar siç duhet dhe nuk kanë tejkaluar 2 minutshin e paraparë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Përveç lajmeve, kronikave zgjedhore e spoteve politike, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale kanë transmetuar edhe intervista e debate dhe forma tjera të prezantimit mediatic. Karakteristikë për shumicën e debateve të transmetuara ishin pyetjet e njëjta dhe hapësira e përafërt për të gjithë përfaqësuesit e SCP-ve pjesëmarrës në një debat.

Në rastet kur përkundër ftesës për debat zgjedhor, përfaqësuesit e SCP-ve kanë munguar, televizionet kanë njoftuar shikuesit për mos shfrytëzimin e hapësirës së dhënë. Shumica e OSHMA-ve kanë qenë të vëmendshëm që edhe renditja në prezantimin e fushatave të SCP-ve në edicionet e lajmeve të jetë sa më e balancuar dhe me një lloj rotacioni ndërsa raportimi gjatë mbulimit të fushatës ishte kryesisht neutral.

Sa i përket distribuimit të kohës (sasisë së dhënë) në edicionet e lajmeve, ofruesit e shërbimeve mediale audio –vizuale kanë arritur balancim më të madh kryesisht tek Subjektet e Certifikuara Politike të cilat kanë pasur aktivitet dhe fushatë më të dendur.

Sidoqoftë, *TV BESA, TV OPINION, TV PRIZRENI, KLAN KOSOVA, TV RROKUM* dhe *TRIBUNA CHANNEL*, ka ofruar hapësirë më të madhe sasiore për subjektin PAN gjatë mbulimit të fushatës krahasuar me subjektet tjera.

OSHMA-të të cilat transmetojnë në gjuhën serbe kanë transmetuar kryesisht fushatat e SCP-ve serbe. Shumica e këtyre medieve ka ofruar hapësirë më të madhe sasiore për subjektin GISL.

Gjuha e përdorur në medie gjatë kësaj fushate ka qenë kryesisht në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale, me përjashtim të disa rasteve të përdorimit të shprehjeve denigruese kundër integritetit territorial të vendit, gjuhës së urrejtjes (kryesisht në spotin politik të SPC GiSL, në disa programe informative apo gjatë disa intervistave të drejtpërdrejta me qytetarë ditën e votimit.)

Shkeljet e gjetura dhe veprimet e KPM-së

Në bazë të monitorimit të kësaj periudhe, është vërejtur se disa nga të licencuarit kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore sa i përket mbulimit të fushatës zgjedhore. Për shkeljet e gjetura, KPM do të ndërmerr masat e parapara sipas nenit 30 të Ligjit të KPM-së.

Shkeljet e evidentuara kanë të bëjnë me:

Spotet politike të paidentifikuara

Gjatë monitorimit të përmbajtjeve programore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore, është vërejtur se disa ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele nuk e kanë bërë identifikimin e spoteve politike, siç parasheh neni 49 paragrafi 6 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të.”

Spotet politike të pa identifikuar nëse janë me apo pa pagesë janë transmetuar në: *TV 21, TV BESA, TV OPINION, TV MIR, TV MOST, TV HERC, TV PULS, TV VALI, TV KIM, TV RROKUM, TV KLAN KOSOVA dhe TV DUKAGJINI.*

Janë transmetuar edhe programe tjera si spote, debate apo tubime zgjedhore, të cilat janë identifikuar si hapësirë me pagesë por nuk janë identifikuar nga kush janë porositur/sponsorizuar. Këto janë transmetuar në: *TV BESA, TV MIR, TV MOST dhe TV PULS.*

Lidhur me këto shkelje, të evidentuara sidomos në fillim të mbulimit të fushatës, KPM përmes një shkrese ka udhëzuar OSHMA-të që të veprojnë në pajtueshmëri me përcaktimet ligjore për identifikimin e spoteve politike. Pas shkresës së dërguar, shumica e OSHMA-ve kanë ardhur në pajtueshmëri duke bërë identifikimi e duhur të spoteve politike.

Prezenca e fëmijëve në spote politike

Që prej fillimit të fushatës zgjedhore, në bazë të monitorimit është vërejtur se ka pasur prezencë të fëmijëve në spote politike reklamuese.

Lidhur me këto shkelje, KPM përmes një shkrese, ka udhëzuar OSHMA-të të veprojnë në pajtueshmëri me nenin 9, paragrafi 7 i Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, përcakton se:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike’.

Edhe pas shkresës së dërguar, shumica e OSHMA-ve kanë vazhduar me transmetimin e spoteve politike, në të cilat fëmijët janë prezent.

Identifikimi i prezencës së fëmijëve në spotet politike është bërë në spotet e subjektit PAN (një i identifikuar si spot politik i AAK dhe një i subjektit PDK) të transmetuar pothuajse në të gjitha televizionet që transmetojnë në gjuhën shqipe: *RTK1, TV21, TV BESA, TV ILIRIA, TV DUKAGJINI, TV SYRI VISION, TV RROKUM, TV KLAN KOSOVA*, spoti politik i LDK-AKR (i identifikuar si spot politik i LDK-së) i transmetuar në *RTK1* (i cili pas transmetimeve të para është tërhequr nga transmetimi) si dhe spotet e subjekteve GiSL dhe SLS, të transmetuar në televizionet që transmetojnë në gjuhën serbe: *TV MIR, TV MOST, TV PULS, TV HERC* dhe *TV KIM*.

Publikimi i sondazheve/hulumtimeve të opinionit

Gjatë periudhës monitoruese, është gjetur se TV DUKAGJINI më 09.06.2017 ka publikuar një sondazh në emisionin Debat Plus, me ç'rast nuk janë treguar parametrat e sondazhit, siç kërkohen me nenin 47.5 të Ligjit për Zgjedhje i cili përcakton që:

“Publikimi ose përfshirja në transmetim të hulumtimeve të opinionit dhe të anketave gjatë periudhës së fushatës dhe që kanë të bëjnë me zgjedhjet përcillet me numrin e gjithëmbarshtëm të respondentëve, emrin e kompanisë realizuese, emrin e partisë përgjegjëse për atë hulumtim, dhe marginën e gabimit”.

Pas komunikimit me TV DUKAGJINI, sondazhet e transmetuara pas kësaj date kanë përfshirë të dhënat e kërkuara sipas nenit 47.5 të Ligjit për Zgjedhje.

Periudha e heshtjes zgjedhore

Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, më 10 dhe 11 qershor 2017, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele kanë transmetuar konferencat për media të disa SCP-ve, ku shihen logot dhe simbole tjera të tyre, reagimet e SCP-ve për parregullsitë dhe keqpërdorimet e ndryshme si dhe deklaratat e kandidatëve të SCP-ve pas votimit të tyre, në kundërshtim me nenin 52.1 të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073 dhe Udhëzuesit të KPM-së i cili përcakton se:

“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon 24 orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve”.

Sipas ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në materialet që i takojnë aktivitetit të fushatës përfshihen tubimet ose fjalimet politike, mbledhjet, prezantimet publike ose ndonjë aktivitet të përgatitur për të propaganduar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet.

Në ditën e votimit, ka pasur raste kur në kuadër të materialeve të transmetuara (sikurse konferencat për media të SCP dhe intervistat e bëra nga OSHMA me qytetarë) janë përfshier materiale që i takojnë aktivitetit të fushatës.

Sipas nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit për Zgjedhje, përcaktohet se:

“Në Kosovë nuk bëhet asnjë publikim ose transmetim i rezultateve të hulumtimit të opinionit publik që ka të bëjë me fushatën e zgjedhjeve, duke përfshirë daljen në

votime, gjatë periudhës që fillon 24 orë para mbylljes zyrtare të vendvotimeve dhe deri në përmbylljen e procesit zgjedhor.”

Më 11 qershor 2017, rreth orës 19:13 minuta, Klan Kosova ka transmetuar rezultatet e hulumtimit të opinionit publik që ka të bëjë me fushatën e zgjedhjeve. Exit Poll-i i porositur nga vet Klan Kosova është transmetuar para përmbylljes së procesit zgjedhor. Lidhur me transmetimin e këtij exit poll-i është parashtruar ankesë nga një SCP.

Shkelje të Kodit të Etikës

Gjatë periudhës monitoruese të mbulimit të fushatës zgjedhore, 31 maj 2017 deri më 11 qershor 2017, është gjetur se në disa raste gjuha e përdorur nga të licencuarit ka qenë në kundërshtim me Kodin e Etikës i cili parasheh dispozita ligjore sa i përket përdorimit të gjuhës së përdorur në përmbytjet programore të të licencuarve të KPM-së.

Këto raste janë gjetur tek:

- Transmetimi i spotit të SCP-së GiSL në TV-të në gjuhën serbe: *TV MIR, TV MOST, TV PULS, TV HERC dhe TV KIM*, me përmbytje të gjuhës së urrejtjes dhe kundër integritetit territorial të vendit. Janë përdorur shprehje kundër “formimit të ushtrisë së Kosovës”, thirrje për “ruajtje nga shuarja e institucioneve të Republikës së Serbisë”, përdorim i shprehjes “Kosovo i Metohija”.
- Intervista në TV PULS transmetuar më 11.06.2017, me një person i prezantuar si kryetar i koalicionit të të zhvendosurve nga KiM, që ka ardhur të votojë. Gjatë kësaj interviste përdoren shprehje si: “Kosova dhe Metohija”, “Kosova dhe Metohija pjesë përbërëse dhe e patjetërsueshme të Serbisë”. Personi i njëjtë ka deklaruar se ka ardhur të votojë subjektin GiSL.

Po ashtu, gjatë një interviste me një qytetar në Ranillug, qytetari ka deklaruar se “vetëm të bëhet diçka në dobi të serbëve, që “Siptari” të mos formojnë atë ushtri të Kosovës, për këtë kam ardhur”.

- Prezantimi i një kronike në TV KIM transmetuar më 02.06.2017 në edicionin e lajmeve Kosma-Dnevnik, ku raportohet për një prononcim të z. Ramush Haradinaj dhënë agjensisë Anadolu. Duke iu referuar z. Haradinaj, në mes tjerash, theksohet se “Ramush Haradinaj, të cilin Serbia e kërkon për krime monstruoze ndaj banorëve serb dhe joshqiptar gjatë konfliktit në Kosovë e Metohi,...
- Transmetimi i një interviste në TV Most më 03.06.2017 me kandidatë të GiSL në të cilën është vërejtur se moderatorja në disa raste përdorë shprehje si: “nga ju varet kush do t’ju përfaqësojë në Parlamentin e Krahinës...”, “...ishte kjo zonja Ceranic, kandidate për deputete në qeverinë e krahinës...”, përdorim i fjalës “Kosova i Metohija”.
- Në të njëjtin televizion, më 10.06.2017 është transmetuar një deklaratë e Ministritë Serb, A. Vulin, sipas të cilit, në mes tjerash, “R.Haradinaj është kriminel i luftës, vrasës i

dëshmuar i grave dhe fëmijëve dhe drejtësia do të vie tek ai” (gjuhë e urrejtjes dhe shkelje e heshtjes zgjedhore);

- TV Most, edhe më datën 11.06.2017, ka transmetuar një intervistë me një person, i prezantuar si kryetar i koalicionit të të zhvendosurve nga KiM, që ka ardhur të votojë. Gjatë kësaj interviste përdoren shprehje si: Kosova dhe Metohija, Kosova dhe Metohija pjesë përbërëse dhe e patjetërsueshme të Serbisë”. Personi i njëjtë ka deklaruar se ka ardhur të votojë subjektin GiSL.

Mos ofrimi i ditarëve me dhe pa pagesë të të licencuarve që kanë mbuluar fushatën zgjedhore

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenit 53, përcaktohet se:

“Komisioni i Pavarur për Media siguron se mediat mirëmbajnë një ditar për të regjistruar kohën e emetimit, dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti. Ditari i vlerëson të gjithë treguesit relevant të ekspozimeve, ndaras për secilin subjekt politik, sipas mënyrës së përcaktuar me rregullat e KPM-së”.

Përmes një shkresë të dërguar para fillimit të fushatës, KPM ka përcjell tek të licencuarit format e Ditarëve me dhe pa pagesë që duhet të mirëmbahen nga mediat, si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre. Nga të licencuarit është kërkuar ta njoftojnë KPM nëse do të mbulojnë fushatën zgjedhore, e në rast të mbulimit ka kërkuar që këta ditarë t'i ofrohen KPM-së pas çdo jave të fushatës zgjedhore.

Brenda afatit të paraparë me Udhëzuesin e KPM-së për Ditarët, vetëm 28 OSHMA kanë sjellë ditarët me regjistrimet për kohën e ofruar me pagesë apo pa pagesë SCP-ve, ndërsa 8 OSHMA kanë njoftuar se nuk do të mbulojnë fushatën zgjedhore në mediumet e tyre.

VI. ANKESAT E PARASHTRUARA

Gjatë periudhës së fushatës për Zgjedhjet 2017, PZAP ka përcjell tek KPM një ankesë të SCP - LDK-, ndaj ofruesit të shërbimit medial audio-vizuel Klan Kosova. Ankesa ka të bëjë me një sondazh të cilin siç pretendon Pala Ankuese, Klan Kosova e ka transmetuar para përfundimit të procesit zgjedhor. Rasti është në proces.

VII. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-TË

Të dhënat në tabelat më poshtë, lidhur me hapësirën e ofruar për SCP-të nga data 31.05.2017 deri më 09.06.2017 janë vetëm për kohën nga ora 16:00-24:00.

Në edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore dhe debatet e transmetuara, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele kanë OSHMA-të e monitoruara u kanë dedikuar këtë hapësirë për SCP-të:

OSHMA me transmetim tokësor me mbulim nacional

RTK 1

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	8654	31.19
	LDK-AKR	7960	28.69
	VV	6649	23.97
	FJALA	1203	4.34
	GIS	496	1.79
	PREBK	353	1.27
	PDS	174	0.63
	DTP	640	2.31
	KTAP	123	0.44
	NDS	196	0.71
	SDA	129	0.46
	VAKAT	303	1.09
	KNRP	445	1.6
	SLS	419	1.51
Total		27744	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PAN	22155	34.8
	LDK-AKR	21949	34.48
	VV	10677	16.77
	FJALA	7020	11.03
	PDU	1860	2.92
	Total		63661

KTV

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha	s	%	
SCP	PAN	3480	33.16
	LDK-AKR	2899	27.63
	VV	3141	29.93
	FJALA	882	8.4
	PDU	92	0.88
Total	10494	100	

Debate/intervista			
Koha	s	%	
SCP	PAN	31472	26.23
	LDK-AKR	40517	33.77
	VV	39868	33.23
	PDS	2709	2.26
	SLS	2709	2.26
	GI za PK	2709	2.26
Total	119984	100	

TV21

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha	s	%	
SCP	PAN	3113	31.3
	LDK-AKR	2780	27.95
	VV	2292	23.05
	FJALA	1028	10.34
	PPL	37	0.37
	SLS	72	0.72
	PDS	126	1.27
	GiSL	129	1.3
	PAK	368	3.7
Total	9945	100	

Debate/intervista			
Koha	s	%	
SCP	PAN	53737	26.18
	LDK-AKR	53737	26.18
	VV	53737	26.18
	FJALA	10430	5.08
	SDA-BSDAK	5425	2.64
	PDU	5441	2.65
	PAI	6332	3.08
	PRR	5245	2.56
	KNRP	5816	2.83
	PDAK	5370	2.62
	Total	205270	100

OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Prizrenit

TV BESA

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	8458	56.67
	LDK- AKR	3741	25.07
	VV	2197	14.72
	FJALA	453	3.04
	KTAP	75	0.5
total		14924	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PAN	10986	57.06
	LDK- AKR	3675	19.09
	VV	3745	19.45
	FJALA	846	4.39
	Total	19252	100

TV OPINION

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	10257	56.82
	LDK- AKR	6885	38.14
	VV	910	5.04
Total		18052	100

TV PRIZRENI

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	8717	61.63
	LDK- AKR	3516	24.86
	VV	1602	11.33
	FJALA	310	2.19
	Total	14145	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PAN	3201	100
Total		3201	100

OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Mitrovicës

TV MITROVICA

TV Mitrovica nuk ka mbuluar fushatën zgjedhore të SCP përmes lajmeve apo kronikave zgjedhore. Para fushatës zgjedhore, ka transmetuar një shpallje me të cilën fton SCP për mundësinë e shfrytëzimit të hapësirës pa pagesë në këtë televizion. Janë transmetuar vetëm spote politike dhe programe me pagesë.

TV MIR

Para fushatës zgjedhore, ka transmetuar një shpallje me të cilën fton SCP për mundësinë e shfrytëzimit të hapësirës pa pagesë në këtë televizion. Janë transmetuar vetëm spote politike dhe programe me pagesë.

TV MOST

Para fushatës zgjedhore, ka transmetuar një shpallje me të cilën fton SCP për mundësinë e shfrytëzimit të hapësirës pa pagesë në këtë televizion.

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	GiSL	7268	100
	Total	7268	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PKS-AGI	1208	41.06
	GiSL	1734	58.94
Total		2942	100

OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Gjilanit

TV LIRIA

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	1240	24.54
	LDK- AKR	1268	25.1
	VV	1214	24.03
	FJALA	364	7.21
	PDAK	520	10.29
	PAI	446	8.83
Total		5052	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PAN	2855	16.73
	LDK- AKR	6703	39.28
	VV	2855	16.73
	PDAK	2326	13.63
	PAI	2326	13.63
	Total		17065

TV ILIRIA

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	3030	50
	LAA	1435	23.68
	VV	1595	26.32
Total		6060	100

TV TEMA

Edicione të lajmeve			
Koha		s	%
SCP	PAN	811	8.15
	LAA	1080	10.86
	VV	1949	19.6
	FJALA	186	1.87
Total		4026	100

Në mungese të arkivës për programin e TV TEMA për tërë periudhën monitoruese, në tabelë nuk janë përfshira të dhënat për periudhën 31 maj deri më 4 qershor 2017.

TV PULS

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PDS	162	6.22
	SLS	51	1.96
	GiSL	2240	85.96
	PKS- AGI	125	4.8
	PAN	28	1.07
	Total		2606

TV VALI

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	3954	42.07
	LDK- AKR	2877	30.61
	VV	2394	25.47
	FJALA	173	1.84
	Total		9398

OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Pejës

TV DUKAGJINI

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	VV	2311	27.73
	LDK-AKR	1937	23.24
	PAN	2946	35.34
	FJALA	254	3.05
	PLE	119	1.43
	PDS	51	0.61
	GISK	21	0.25
	VAKAT	133	1.6
	PREBK	85	1.02
	KDTP	113	1.36
	NDS	49	0.59
	PDAK	32	0.38
	PAI	42	0.5
	GiSL	48	0.58
	SLS	28	0.34
	KNRP	70	0.84
	IRDK	26	0.31
	PDTK	14	0.17
	SDA	14	0.17
KTAP	42	0.5	
Total		8335	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	VV	33752	20.58
	LDK-AKR	62710	38.24
	PAN	61625	37.58
	FJALA	1096	0.67
	KNRP	960	0.59
	PLE	960	0.59
	PAI	2880	1.76
Total		163983	100

TV SYRI VISION

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	VV	1473	18.61
	LDK-AKR	3677	46.46
	PAN	2764	34.93
Total		7914	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	VV	15042	29.86
	LDK-AKR	12463	24.74
	PAN	21940	43.55
	FJALA	284	0.56
	PLE	654	1.3
Total		50383	100

OSHMA me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes

RTK2

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PDS	184	12.03
	GiSL	1069	69.87
	PKS-AGI	170	11.11
	PAN	81	5.29
	LDK-AKR	26	1.7
Total		1530	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	GIG	2045	2.29
	PDS	13362	14.94
	SLS	16818	18.8
	GiSL	19058	21.3
	PKS-AGI	19113	21.36
	GI za PK	19069	21.31
Total		89465	100

KLAN KOSOVA

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	6598	40.96
	LDK-AKR	4457	27.67
	VV	4442	27.57
	Fjala	119	0.74
	GISL	397	2.46
	PKS	97	0.6
Total		16110	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PAN	29563	40.03
	LDK-AKR	25002	33.85
	VV	18864	25.54
	PDU	431	0.58
Total		73860	100

RROKUM TV

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	2487	34.28
	LDK-AKR	2493	34.37
	VV	1917	26.43
	FJALA	284	3.92
	GiSL	73	1.01
Total		7254	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PAN	22076	30.34
	LDK-AKR	38015	52.25
	VV	5152	7.08
	FJALA	1088	1.5
	GiSL	2131	2.93
	PAI	2131	2.93
	PLE	2159	2.97
Total		72752	100

TRIBUNA CHANNEL

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
SCP	PAN	2712	39.24
	LDK- AKR	2401	34.74
	VV	1652	23.9
	GISL	50	0.72
	PKS	97	1.4
Total		6912	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PAN	39486	39.15
	LDK/A/A	45773	45.38
	VV	15596	15.46
Total		100855	100

TV KIM

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
	GIG	50	1.65
SCP	PDS	202	6.67
	SLS	405	13.37
	GiSL	1729	57.08
	PKS- AGI	202	6.67
	GI za PK	238	7.86
	PAN	203	6.7
Total		3029	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	PDS	6870	30.47
	SLS	6870	30.47
	PKS-AGI	6870	30.47
	GI za PK	1939	8.6
Total		22549	100

VIII. SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË GJATË MONITORIMIT TË PAJTUESHMËRISË SË TË LICENCUARVE TË KPM-SË

Për shkak të numrit të madh të të licencuarve të KPM-së, nga të cilët 83 janë radio, 20 TV me transmetim tokësor dhe 51 TV me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, vëllimit të punëve e numrit të vogël të stafit monitorues, KPM ka monitoruar 23 TV nacionale, regjionale/lokale me transmetim tokësor si dhe OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes. Ndërsa, radiot kanë mbetur të monitorohen në bazë të ankesave të palëve.

Gjatë monitorimit të OSHMA-ve të cilat kanë mbuluar fushatën zgjedhore 2017 sfidë ka qenë buxheti i pamjaftueshëm (edhe përkundër përkundër kërkesës së bërë nga KPM sapo KQZ ka bërë njoftimin për mbajtjen zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme, MF nuk ka ndarë mjete shtesë për të mundësuar me sukses përmbushjen e obligimit ligjor). Në mungesë të buxhetit dhe pamundësisë për të angazhuar staf shtesë, monitorimi i një numri të konsiderueshëm prej 23 OSHMA-ve është bërë vetëm nga një staf prej 8 zyrtarëve. Kjo përbën ngarkesë të madhe të realizimit të monitorimit shtesë dhe enkas vetëm të mbulimit të fushatës, krahas angazhimeve tjera që rrjedhin nga trajtimi i rasteve ditore ex-officio dhe me ankesë.

KPM është duke vërejtur që në çdo vit zgjedhor, përkundër përvojës disa vjeçare me mbulimin e fushatave zgjedhore, lind nevoja që me mediat të mbahet një komunikim i vazhdueshëm me sqarime të njëjta edhe pse me kohë dhe rregullisht KPM ju dërgon të licencuarve Udhëzuesit adekuat së bashku me shkresa me sqarime shtesë.

Prandaj është mëse e nevojshme që KPM-së, në çdo vit zgjedhor, t'i sigurohen resurset e nevojshme, dhe buxhet shtesë, për të mundësuar:

1. realizimin e monitorimit të fushatës zgjedhore dhe aktiviteteve përgatitore para fushatës zgjedhore;
2. angazhimin e stafit shtesë dhe përgatitjen e tyre për monitorimin e mediave gjatë fushatave zgjedhore;
3. organizimin e takimeve dhe debateve me përfaqësues të medieve dhe palëve tjera të interesit, me qëllim të qartësimin të të gjitha dilemave që lidhen me mbulimin e fushatës zgjedhore (duke përfshirë edhe ndarjen e rolit e KPM-së nga institucionet tjera përgjegjëse për procesin zgjedhor).

IX. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në bazë të të gjeturave nga monitorimi i periudhës zgjedhore, të prezantuara më lartë, KPM konkludon se:

- OSHMA-të kanë raportuar kryesisht në mënyrë neutrale, në pajtueshmëri me Kapitullin VIII të Ligjit për Zgjedhje si dhe Kodin e Etikës për OSHMA-të.2. Gjatë mbulimit të fushatës, shumica e OSHMA-ve kanë ofruar diversitet programesh informative si: lajme, kronika, debate e intervista, duke ofruar kështu hapësirë dhe mundësi për prezantimin e fushatave dhe shpalosjen e platformave politike të SCP-ve si dhe pasqyrimin e atmosferës elektorale në përgjithësi.
- *RTKI, KTV dhe TV 21*, sa i përket hapësirës së ofruar në përmbajtje programore, kanë arritur balancim më të madh kryesisht të SCP-të të cilat kanë pasur aktivitet dhe fushatë më të dendur politike.
- *TV BESA, TV OPINION, TV PRIZRENI, KLAN KOSOVA, TV RROKUM dhe TRIBUNA CHANNEL* gjatë raportimit kanë ofruar hapësirë më të madhe sasiore për subjektin PAN krahasuar me subjektet tjera.
- TV Most, TV Puls, TV Mir, TV Kiss, të cilat transmetojnë në gjuhën serbe kryesisht kanë ofruar hapësirë më të madhe sasiore për subjektin GISL.
- Në ditën e votimit, disa nga OSHMA-të kanë mbuluar aktivitete të cilat kanë rënë ndesh me heshtjen zgjedhore.

Në bazë të të gjeturave nga monitorimi i periudhës zgjedhore, të prezantuara më lartë, KPM rekomandon që:

1. Spotet politike duhet qartësisht të identifikohen nëse janë me apo pa pagese si dhe të tregohet individ/subjekti përgjegjës për të, sipas nenit 49.6 të Ligjit për Zgjedhje.
2. Me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve në përmbajtjet programore, në pajtim me Kodin e Etikës, të licencuarit duhet të shmangin transmetimin e spoteve politike me prezencë të fëmijëve. Kjo me qëllim të evitimit të keqpërdorimeve të tyre për qëllime/efekte politike.
3. Të licencuarit duhet të kenë kujdes gjatë mbulimit të periudhës së heshtjes zgjedhore, veçmas gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta ku ekziston mundësia e keqpërdorimit të hapësirës së ofruar qoftë nga kandidatët apo edhe qytetar të intervistuar, për të bërë thirrje apo promovim për ndonjë SCP të caktuar, e të cilat mund të ndikojnë në procesin zgjedhor.
4. Të licencuarit duhet të evitojnë transmetimin e reagimeve apo konferencave për media të SCP-ve, të cilat në shumicën e rasteve organizohen për qëllime të tyre, më shumë të natyrës propaganduese, e në prapavijë të të cilave zakonisht vërehen logo/simbole dhe flamuj partiak, moto të fushatës së tyre, numri garues dhe detaje tjera që bien në kundërshtim me Nenin 52.1 të Ligjit për Zgjedhje.

Në periudhën e heshtjes zgjedhore, institucioni i vetëm zyrtar për informim lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, parregullsitë dhe keqpërdorimet e mundshme në vendvotimeve është Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ).

5. Transmetimi/publikimi i hulumtimeve të opinionit/sondazheve lidhur me zgjedhjet duhet të përmbajnë të dhënat e parapara sipas nenit 47.5 i Ligjit për Zgjedhje, si dhe të mos publikohen para përfundimit të procesit zgjedhore siç përcakton neni 52.2 i Ligjit për Zgjedhje.
6. Të licencuarit të ofrojnë në KPM ditarët për kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti.
7. Gjuha e përdorur gjatë fushatave zgjedhore duhet në jetë në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale, duke respektuar parimet etike, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut, integritetin territorial. Gjithashtu, nuk duhet të përmbaj gjuhë të dëmshme, fyese, denigruese dhe gjuhë të urrejtjes apo materiale që mund të nxisin dhunë, diskriminojnë apo njollosin një grup të caktuar të shoqërisë.

###

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

5 korrik 2017

